

COLACEM ALBANIA SHPK

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIM HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8-35

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarit dhe Drejtimit të Colacem Albania Shpk,

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Colacem Albania Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, duke përjashtuar efektet e mundshme të çështjes së përshkruar në seksionin e raportit tonë "Baza për Opinion me Rezervë", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022, si dhe të performancës së saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza e Opinionit me rezervë

Zhvlerësimi i aktiveve aftagjate materiale

Siç shpjegohet në shënimin shpjegues 6 të pasqyrave financiare, aktivet materiale aftagjate paraqiten në shumën 1,955,215,075 LEK më 31 dhjetor 2022 (2021: 2,151,188,762 LEK). Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2022 Shoqëria ka gjeneruar një humbje prej 11,997,888 LEK (2021: fitim 74,164,225 LEK) dhe humbje të akumuluar prej 2,990,607,696 LEK (2021: 2,978,608,808 LEK) duke treguar evidencë të arsyeshme që vlera e rikuperueshme e aktiveve materiale aftagjate mund të jetë më e ulët se vlera neto kontabël më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021. Siç kërkohet nga SNK 16 "Aktivet materiale dhe jomateriale aftagjate", drejtimi ka bërë një vlerësim të vlerës së rikuperueshmerisë bazuar në supozimet mbi vlerën në përdorim të aktiveve materiale aftagjate dhe përshkruan parashikimet e përdorura në këtë vlerësim duke konkluduar që nuk ishte i nevojshëm regjistrimi i një humbje nga zhvlerësimi më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022. Këto supozime paraqesin investime shumë të kufizuara për të mbështetur rritjen e aktivitetit dhe zhvlerësimin e aktiveve materiale aftagjate ekzistuese dhe ndryshim në kapitalin qarkullues neto është zero.

Në vijim të sa më sipër, në inventar është përfshirë shuma 15,397,461 LEK, e klasifikuar si pjesë këmbimi të përdorura për mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve. Sipas SNK 16 "Aktivet Materiale Aftagjate" paragrafi 8, në qoftë se pjesët e këmbimit përdoren për mirëmbajtjen e aktiveve aftagjate materiale, duhet të klasifikohen në të njëjtën kategori të aktiveve aftagjate materiale. Drejtimi nuk i ka klasifikuar pjesët e këmbimit tek aktivet aftagjate materiale. Në qoftë se drejtimi do i kishte klasifikuar pjesët e këmbimit në aktive materiale aftagjate, vlera e inventarit do të ullej me 15,397,461 LEK, ndërsa vlera e aktiveve aftagjate materiale do të rritej me 15,397,461 LEK dhe do të ishte subjekt i zhvlerësimit, siç kërkohet nga SNK 36. Meqenëse nuk na është dhënë evidencë auditimi e mjaftueshme dhe e përshtatshme lidhur me supozimet e përdorura dhe në mungesë të procedurave alternative, ne nuk jemi në gjendje të sigurohemi mbi vlerën e rikuperueshme të shumave të regjistruara si aktive materiale aftagjate dhe inventarin e klasifikuar si pjesë këmbimi të përdorura për mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022 dhe 2021.

Baza e Opinionit me rezervë (Vazhdim)

Meqenëse vlera e rikuperueshme e aktiveve materiale afatgjata ndikon në përcaktimin e performancës financiare dhe flukseve të mjeteve monetare, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse mund të kenë qenë të nevojshme veprime rregulluese në lidhje me aktivet materiale afatgjata të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar, humbjes së vitit të paraqitur në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe fluksit të mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit të paraqitur në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitet që mbyllen më 31 dhjetor 2022 dhe 2021.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi "BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit me rezervë.

Pasiguri materiale në lidhje me Parimin e vijimësisë

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues 2 d) të pasqyrave financiare, ku tregohet se Shoqëria ka pësuar humbje të akumuluar prej 2,990,607,696 LEK më 31 dhjetor 2022 (2021: 2,978,608,808 LEK). Siç është paraqitur në shënimin shpjegues 2 d), këto ngjarje ose kushte së bashku me çështjet e tjera të përshkruara në shënimin shpjegues 2 d), tregojnë se ekziston një pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, përgatitur nga Drejtimi në përputhje me Nenet 17 dhe 19 të Ligjit nr. 25/2018 datuar 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe Raporti i drejtimit të brendshëm parashikohet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit të pavarur. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinioni në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Pasi të lexojmë Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, nëse arrijmë në përfundimin se në to ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rruga e Kavajës, Ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji,

Godina H, Kati 2, Tiranë, Shqipëri

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H

Auditues Ligjor

Partner Angazhuar

Enida Cara

3 korrik 2023

Tiranë, Shqipëri



COLACEM ALBANIA SHPK
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
AKTIVE MATERIALE			
AFATGJATA	6		
Toka		249,310,171	249,310,171
Përmirësime të tokës		28,303,455	32,080,698
Ndërtesa		650,601,067	716,676,098
Makineri dhe pajisje		922,649,999	1,074,934,558
Aktive të tjera materiale		17,594,746	31,127,283
Aktive në proces		86,755,637	47,059,954
		<u>1,955,215,075</u>	<u>2,151,188,762</u>
Aktive jo materiale afatgjata			
Aktive jo materiale afatgjata	7	2,669,130	3,382,181
		<u>2,669,130</u>	<u>3,382,181</u>
TOTALI I AKTIVEVE			
AFATGJATA		<u>1,957,884,205</u>	<u>2,154,570,943</u>
AKTIVE AFATSHKURTR			
Inventari	8	482,893,452	327,297,431
Llogari të arkëtueshme	9	181,285,867	146,710,447
Aktive të tjera	10	421,720,789	269,096,197
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	11	35,335,660	36,266,295
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	12	104,475,877	106,499,843
TOTALI I AKTIVEVE			
AFATSHKURTA		<u>1,225,711,645</u>	<u>885,870,213</u>
TOTALI I AKTIVEVE		<u>3,183,595,850</u>	<u>3,040,441,156</u>
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	13	5,737,034,235	5,737,034,235
Humbja e akumuluar	23	(2,990,607,696)	(2,978,608,808)
TOTALI I KAPITALIT		<u>2,746,426,539</u>	<u>2,758,424,427</u>
TOTALI I DETYRIMEVE			
AFATGJATA		<u>-</u>	<u>-</u>
TOTALI I DETYRIMEVE			
AFATSHKURTRA			
Llogari të pagueshme	14	395,330,204	243,340,454
Detyrime të tjera	15	10,514,811	7,351,979
Provizione afatshkurtra	16	31,324,296	31,324,296
TOTALI I DETYRIMEVE			
AFATSHKURTRA		<u>437,169,311</u>	<u>282,016,729</u>
TOTALI I DETYRIMEVE		<u>437,169,311</u>	<u>282,016,729</u>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE			
KAPITALIT		<u>3,183,595,850</u>	<u>3,040,441,156</u>

Pasqyrat financiare për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2022 janë miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 05 maj 2023 dhe janë nënshkruar nga:

COLACEM
ALBANIA SHPK
 Ad. RRUGA NATIONALE SHK - SH Km.7
 Peshkopi, Mbrojtje
 Administrator

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet, pjesë perberese e pasqyrave financiare nga faqja 8 deri 35.

COLACEM ALBANIA SHPK
PASQYRA E FITIM HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E
MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Për vitin mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhurat	17	3,646,017,855	2,489,767,763
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë operative	18	7,086,054	852,644
Shpenzime te kryera dhe te kapitalizuara per aktive te ndertuara vete (reduktim shpenzimi)	19	20,247,760	-
Shpenzime materialesh	20	(2,618,697,388)	(1,722,696,750)
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë operative	21	(730,020,701)	(362,281,103)
Shpenzime personeli	22	(103,294,865)	(97,406,316)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	(239,231,352)	(236,281,033)
(Humbja)/ Fitimi nga aktiviteti operativ		(17,892,637)	71,955,205
Shpenzime interesi		(433,024)	(2,593)
Fitime nga përkthimi i monedhave të huaja		10,081,818	2,213,650
Shpenzime të tjera financiare		(2,493,709)	(2,037)
Totali i fitimit financiar	23	7,155,085	2,209,020
(Humbja)/Fitimi para tatimit		(10,737,552)	74,164,225
Shpenzim i tatim fitimit	24	(1,260,336)	-
(Humbja)/Fitimi neto i vitit financiar		(11,997,888)	74,164,225
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		(11,997,888)	74,164,225

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese, pjesë përbërëse e pasqyrave financiare nga faqja 8 deri 35.

COLACEM ALBANIA SHPK
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR
2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek)

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti operativ		
(Humbja)/ Fitimi pas tatimit	(11,997,888)	74,164,225
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	239,231,352	236,281,033
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(3,306,921)	(570,980)
Fitim i parealizuar neto nga përkthimi i monedhave të huaja	13,019,654	8,901,119
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin operativ para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet	236,946,197	318,775,397
 Rënie/(ritje) në llogari të arkëtueshme	 (34,575,420)	 23,817,350
Rritje në aktive të tjera	(151,693,957)	(43,818,353)
Rritje në inventarë	(155,596,021)	(16,827,677)
Rritje/(renie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	156,412,918	(189,810,546)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	(1,260,336)	-
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ	50,233,381	92,136,171
 Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti investues		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	(42,544,614)	(68,177,932)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	3,306,921	570,980
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues	(39,237,693)	(67,606,952)
 Rënie neto në mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	10,995,689	24,529,219
 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	106,499,843	91,632,654
Efekt i ndryshimeve të kurseve të këmbimit në mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	(13,019,654)	(9,662,030)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	104,475,877	106,499,843

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shenimet shpjeguese, pjesë përbërëse e pasqyrave financiare nga faqja 8 deri 35.

COLACEM ALBANIA SHPK
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek)

	Kapitali nënshkruar	Humbje e akumuluar	Totali
Teprica më 1 janar 2021	5,737,034,235	(3,052,774,033)	2,684,260,202
Fitimi i vitit	-	74,164,225	74,164,225
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	74,164,225	74,164,225
Teprica më 31 dhjetor 2021	5,737,034,235	(2,978,609,808)	2,758,424,427
Teprica më 1 janar 2022	5,737,034,235	(2,978,609,808)	2,758,424,427
Humbja e vitit	-	(11,997,888)	(11,997,888)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i humbjeve të tjera gjithëpërfshirëse	-	(11,997,888)	(11,997,888)
Teprica më 31 dhjetor 2022	5,737,034,235	(2,990,607,696)	2,746,426,539

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese, pjesë përberese e pasqyrave financiare nga faqja 8 deri 35.

COLACEM ALBANIA SHPK
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31
DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHEM

Colacem Albania Shpk (më poshte “Shoqëria”) e ka selinë ligjore në rrugën nacionale Balldre-Lezhë, km7. Shoqëria është regjistruar si person juridik më 07 nëntor 2007 me numër identifikues K72306010V. Shoqëria është një shoqëri shqiptare e cila zotërohet 100% nga Colacem SPA me seli në Via della Vittoria, 60 06024 Gubbio PG, Italy. Palët përfundimtare kontrolluese të Shoqërisë janë: Carlo Colaiacovo Holding Srl, Franco Colaiacovo Gold Srl, Giovanni Colaiacovo Holdings Srl, Pasquale Colaiacovo Holding Srl.

Aktiviteti kryesor i Colacem Albania Sh.p.k është prodhimi dhe tregtimi i çimentos. Shoqëria ka filluar prodhimin e çimentos gjatë vitit 2013.

Shoqëria ka patur 58 punonjës më 31 dhjetor 2022 (2021: 58).

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me SNRF.

b) Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të kontatuara.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek shqiptar (LEK), që është dhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

d) Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në shënimet e detyrimeve të vazhdueshme në datën e raportimit.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën e drejtimit dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në këto rrethana. Pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojnë në një rezultat që kërkon një rregullim material në shumën e njohur të aktiveve dhe detyrimeve të ndikuara në periudhat e ardhshme.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

• Fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve

Informacionet lidhur me fushat e rëndësishme të pasigurisë për vlerësimet dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të cilat kanë efekt shumë të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare përfshijnë:

- Supozimi i parimit të vijimësisë
- Zhvlerësimin dhe amortizimin e aktiveve afatgjata
- Provigjonet për borxhet e këqija
- Pjeset përberese të aktiveve afatgjata materiale
- Kostot e nxjerrjes dhe rehabilitimit

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

- **Gjykime kritike në lidhje me aplikimin e standarteve të kontabilitetit**

Gjykimet kritike në vijim kanë efektin me të madh në shumën e njohur në pasqyrat financiare:

- **Supozimi i parimit të vijimësisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

Shoqëria ka krijuar humbje operative në të kaluarën duke akumuluar humbje në vlerë prej 2,990,607,696 LEK më 31 dhjetor 2022. Në vitin 2022 Shoqëria ka rezultuar me humbje kontabël prej 11,997,888 (2021: fitim 74,164,225 LEK. Drejtimi beson që Shoqëria do të vijojë aktivitetin e saj, e për vitet në vazhdim do të operojë me fitim.

Shoqëria ka përfituar shtyrjen e afatit të lejes minerare të shfrytëzimit më 28 gusht 2018 nga Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë për një periudhë 10 vjeçare për nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të gurit gëlqeror nga Mali i Kakariqit që ndodhet në Balldre, Lezhë. Shoqëria nuk ka qëllim të likuidojë ose të ndërpresë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2022. Drejtimi pret që Shoqëria të vazhdojë të jetë fitimprurëse në vitet në vijim dhe aftësia e saj për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë nuk do të ndikohet. Aftësia e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë varet nga burimet financiare të shoqërisë mëmë. Bordi Drejtues i Colacem Italy SpA me një vendim të datës 31 maj 2021 vendosi rritjen e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë nga kontributi shtesë i shoqërisë mëmë prej 5,386,914,235 LEK. Drejtimi pranon se pasiguria mbetet mbi aftësinë e Shoqërisë për të përmbushur kërkesat e saj për financim. Megjithatë, Drejtimi pret që Shoqëria të ketë burime të përshtatshme për të vazhduar operacionet e saj në të ardhmen e parashikueshme.

Në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria bazuar në sa më sipër dhe gjithashtu në përputhje me planin financiar të miratuar në vitet në vijim, pret të rrisë aktivitetin e saj operacional dhe ka parashikuar të arrijë një rezultat pozitiv në vitet në vijim. Rritja e konsiderueshme e shitjeve të Shoqërisë (47% krahasuar me shitjet e vitit 2021) është kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve. Vëllimet e shitura kanë pasur një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2021. Rënia prej 2.2% në shitjet lokale u kompensua më shumë nga rritja me rreth 11% e vëllimeve të eksportuara. Për sa i përket çmimeve të shitjes, ato shënuan një rritje të ndjeshme, gjë që justifikon trendin në rritje të xhiros. Megjithatë, kostot e prodhimit janë rritur edhe më shumë. Çmimet e lëndëve të para, mbi të gjitha blerja e klinkerit dhe kosto e energjisë elektrike janë rritur.

Në datën e pasqyrave financiare të Colacem Albania shpk, shitjet janë në nivelet dhe çmimet që garantojnë vijueshmërinë e aktivitetit sipas parashikimeve.. Megjithatë, në datën e pasqyrave financiare, Colacem Albania shpk vazhdon të përmbushë detyrimet e veta pasi ato janë të detyrueshme dhe prandaj vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë.

- **Zhvlerësimi dhe amortizimi i aktiveve afatgjata**

Në çdo datë raportimi, drejtimi vlerëson jetën e dobishme të aktiveve afatgjata dhe koston përkatëse të amortizimit. Ky vlerësim bazohet në pervojën e drejtimin, praktikën e industrisë dhe karakteristikat e aktivitetit. Vlerësimet e drejtimin për jetën e dobishme të pasurive mund të ndryshojnë ndjeshëm si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e biznesit. Gjatë vitit aktual, drejtimi përcaktoi se jeta e dobishme e ndërtësive dhe pajisjeve dhe pronave nuk ka ndryshuar.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)****• Pjesët përbërëse të aktiveve afatgjata materiale**

Pjesët e këmbimit janë pjesë të këmbyeshme të aktiveve afatgjata materiale, të cilat konsiderohen të jenë thelbësore për të mbështetur mirëmbajtjen rutinë, riparimin dhe rregullimin e aktiveve materiale ose për t'u përdorur në raste emergjente për riparime. Shoqëria ka llojet e mëposhtme të tipeve të pjesëve të këmbimit:

- Pjesë e aktiveve afatgjata materiale dhe zhvlerësohen nga data e blerjes për një periudhë që është më e shkurter se jeta e dobishme e përberesit apo jeta e dobishme e impiantit në të cilin do të përdoret. Këto nuk janë pjesë të inventarit, me kusht që të plotësohen kriteret e kapitalizimit sipas aktiveve afatgjata materiale.
- Pjesë këmbimi të cilat janë pjesë të këmbyeshme të aktiveve afatgjata dhe pjesë të ciftuara specifike të linjës/linjave të prodhimit me kohë të gjatë përdorimi dhe do të zëvendësohen dhe rinovohen shpesh. Ato kapitalizohen si pjesë e aktiveve afatgjata materiale ku plotësohen kriteret e kapitalizimit. Amortizimi fillon nga dita e instalimit të këtyre artikujve e fabrikë dhe periudha e amortizimit është më e shkurtër se jeta e dobishme e pjesës së këmbimit dhe jeta e dobishme e mbetur e aktivitetit afatgjatë materia përkatës në të cilin është instaluar. Këto nuk janë pjesë e inventarit.
- Pjesë këmbimi të përgjithshme dhe sende të tjera të konsumit të cilat nuk janë të një natyre kritike dhe kanë natyrë të përgjithshme (jo specifike për një impiant dhe mund të përdoren në impiante të ndryshme ose linja prodhimi dhe cdo send tjetër që mund të kërkohet në cdo kohë për lehtësimin e funksionimit të impiantit). Ato zakonisht klasifikohen si "materiale të konsumit dhe pjesë këmbimi" nën inventar, përveç nëse tejkalojnë pragun e kapitalizimit dhe kanë një jetë të dobishme më shumë se një vit, ku regjistrohen si aktive afatgjata materiale. Artikujt e regjistruar si inventar janë subjekt i vlerësimit për testin e zhvlerësimit dhe paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse pas instalimit apo përdorimit të tyre. Kur artikujt të tillë plotësojnë kriteret e kapitalizimit, metoda e tyre e amortizimit është ngjashme me artikujt e riparueshëm, të përmendur më lart.

• Kostot e nxjerrjes dhe rehabilitimit

Shoqëria ka vlerësuar detyrimin e saj për rehabilitimin e karerës dhe kostot e caktimit të pajisjeve dhe makinerive për shfrytëzimin e karerës. Rehabilitimi i sipërfaqes si dhe caktimi (montimi) kanë qenë pjesë e aplikimit për marrjen e lejes së shfrytëzimit nga AKBN. Në të vërtetë, shfrytëzimi i mineraleve ka qenë shumë më i ulët se parashikimi fillestar i Shoqërisë (duke patur parasysh që klinkeri importohet). Për më tepër, Shoqëria parashikon që ajo do të vazhdojë të jetë në këto nivele për të ardhmen afatshkurter. Leja parashikon deri në 7 milionë m³ rezerva të përdorshme (për periudhën 2018-2028) ndërsa prodhimi vjetor është 19,308 m³ për vitin 2022 (2021: 22,811 m³). Kjo do të thotë që sipërfaqja e nederhyrë për shfrytëzim dhe e nevojshme për e rehabilitueshme është shumë e vogël sesa ishte parashikuar ose reflektuar në lejen e shfrytëzimit. Sipërfaqja maksimale që mund të ketë nevojë për rehabilitim deri në fund të lejes së shfrytëzimit është rreth 14.94 ha, por sipas parashikimeve afatshkurtra që lidhen ngushtë me ciklin e plotë të prodhimit të cimentos, nuk kalon 2 ha. Sipas kostos së rehabilitimit të parashikuar nga aktet normative në projektin e paraqitur për zgjatjen e afatit të lejes së shfrytëzimit, miratuar me aktin e miratimit nr. 1276/1 të cështjes LC-7962-04-2018, datë 06.04.2018 është 322,750 Lekë/ha., Dd duke marrë parasysh sipërfaqen reale për të rikuperuar zbritjen, rezulton në një shumë të papërfillshme.

• Kontrata e qerasë me Komunën Balldren

Shoqëria ka një kontratë qiraje me komunën Balldren për një sipërfaqe me qira prej 20.77 Ha, për një periudhë 30 vjetecare. Për këtë sipërfaqe, Shoqëria ka të drejtë të përdorë mineralin (gur gelqeror) që në fakt është arsyeja e marrjes me qira të kësaj zone.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

• Kontrata e qerasë me Komunën Balldren (vazhdim)

Kjo kontratë qiraje është jashtë fushës së veprimit të SRNF-16 në përputhje me paragrafin 3. (a): “Njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për të gjitha qiratë, përfshirë qiranë për aktivet me të drejtë përdorimi në një nën-qira, përveç: (a) qira për kërkim ose shfrytëzimin e mineraleve, naftës, gazit natyror dhe byrimeve të tjera të ngjashme të parinovueshme”. Duke patur parasysh që qellimi i qirasë është saktësisht dhe vetëm për përdorimin e mineraleve (gur gelqeror) në këtë zonë, Shoqëria nuk zbaton SNRF 16 për këtë kontratë.

• Kalkulimi i provizionit për klientët

Gjatë matjes së humbjes së pritshme nga klientet, Shoqëria përdor informacion të arsyeshëm dhe larg pamës nga larg, i cili bazohet në supozime për lëvizjen e ardhshme të drejtuesve të ndryshëm ekonomikë dhe sesi këta drejtues do të ndikojnë tek njëri-tjetri.

Humbja e pritshme si mospagim është një vlerësim i humbjes që del nga mospagimi. Ajo bazohet në diferencën midis flukseve të parave të gatshme kontraktuale dhe atyre që huamarrësi do të priste të merrte, duke marrë parasysh flukset e parave nga kolaterali dhe përmirësimet integrale të kredisë.

Probabiliteti i mospagimit përbën një input kryesor në matjen e humbjeve të pritura. Probabiliteti i mospagimit është një vlerësim i mundësisë së mospagimit gjatë një periudhe të caktuar kohore, llogaritja e të cilit përfshin të dhëna historike, supozime dhe pritje të kushteve të ardhshme.

3. STANDARDE, INTERPRETIME DHE AMENDIME EFEKTIVE

a) Standarde, interpretime dhe amendime efektive në periudhën aktuale

Politikat kontabel të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2022:

- Aktivet afatgjata materiale (toka, ndertesa, makineri e paisje): të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16). Ndryshimet ndalojnë zbritjen nga kostoja e një aktivi afatgjatë (toka, ndertesa, makineri e paisje), çdo të ardhur nga shitja e artikujve të prodhuar duke e sjellë atë aktiv në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë në gjendje të funksionojë në mënyrën kerkuar nga drejtimi. Në vend të kësaj, Shoqëria njeh të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostot për prodhimin e këtyre artikujve në fitim dhe humbje. Këto ndryshime nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- Kontratat e veshitja – Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37) - Ndryshimet specifikojnë se “kostoja e përbushjes” së një kontrate përfshin kostot që lidhen drejtpërdrejt me kontratën. Kostot që lidhen drejtpërdrejt me një kontratë mund të jenë ose kosto shtesë të përbushjes së asaj kontrate (p.sh. puna direkte, materialet) ose një shpërndarje e kostove të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përbushjen e kontratave (p.sh. shpërndarja e normes së amortizimit për një ndertese, makineri dhe pajisje të përdorura në përbushjen e kontratës). Këto ndryshime nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41)- Përmirësimet vjetore në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41 nuk kanë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- Referencat në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)- Ndryshimet përditësojnë një referencë të vjetëruar ndaj kuadrit konceptual të SNRF 3, pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat në standard. Ndryshimet nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. STANDARDE, INTERPRETIME DHE AMENDIME EFEKTIVE

b) Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklarimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar me poshte. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të bëhen efektive.

Ndryshimet e mëposhtme janë në fuqi për periudhën që fillon më 1 janar 2023:

- *SNK 1 - Paraqitja e Pasqyrave Financiare* – (Ndryshimet në SNK 1); Paraqitja e politikave kontabel: ndryshimet kërkojnë që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për politikën e saj kontabël që kanë efekte materiale, në vend të politikave të saj të rëndësishme kontabël. Për më tepër, ndryshimet shpjegojnë se si një njësi ekonomike mund të identifikojë një politikë kontabël që ka efekte materiale. Detyrimet afatgjata me marrëveshje (hyrja në fuqi më 1 janar 2024); ndryshimi sqaron se si kushtet me të cilat një njësi ekonomike duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një pasivi.
- *SNRF 17- Kontratat e Sigurimit*; SNRF 17 kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe ofron një qasje më uniforme matjeje dhe paraqitjeje për të gjitha kontratat e sigurimit;
- *Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9* - Informacion Krahësues (ndryshime në SNRF 17); ndryshimi i lejon njësitë ekonomike që zbatojnë për herë të parë SNRF 17 dhe SNRF 9 në të njëjtën kohë të paraqesin informacion krahasues rreth aktiveve financiare sikur kërkesat e klasifikimit dhe matjes të SNRF 9 të ishin zbatuar për atë aktiv financiar edhe më parë.

Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, të cilat nuk janë ende në fuqi, nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

a) Aktivet materiale afatgjata

Zërat e aktiveve materiale afatgjata paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshijnë koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe kosto të tjera që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Kostot e para-operimit gjatë fazës së fillimit, neto nga të ardhurat nga shitja e prodhimit provë përfshihen si pjesë e kostonë së zërave të aktiveve afatgjata materiale, nëse ato janë kosto drejtpërdrejt të ngarkueshme të cilat plotësojnë kriterin e njohjes dhe vetëm nëse aktiviteti është në kushte pune.

Kur pjesë të aktiveve afatgjata janë kosto të ndjeshme në krahasim me koston totale të aktivitetit dhe kur këto pjesë/komponentë kanë jetë të dobishme të ndryshme, Shoqëria duhet të njohë këto pjesë si elementë të veçanta të aktiveve afatgjata materiale dhe t'i amortizojë rrjedhimisht.

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve materiale afatgjata njihet me vlerën mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhme që i atribuohen atij elementi do t'i përkasin Shoqërisë, dhe nëse kostoja e tij mund të matet më besueshmëri. Konkretisht, nëse një inspektim i madh është kryer, kostot e tij direkte njihen në vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale nëse kriteret e njohjes plotësohen. Të gjitha kostot e shërbimeve ditore të aktiveve materiale afatgjata njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

Vlera aktuale e kostot së pritur për çaktivizimin (cmontimin) e një aktiviteti pas përdorimit të tij përfshihet në koston e aktivitetit përkatës nëse përmeshen kriteret e njohjes për një provizion. Shoqëria do të vlerësojë në mënyrë periodike pritjet dhe vlerësimet për detyrimin e çaktivizimit.

Zhvlerësimi është njohur në pasqyrën e performancës financiare bazuar në jetën e dobishme të aktivitetit, llogaritur në mënyrë lineare. Toka ku është vendosur fabrika është e njohur veçant dhe nuk amortizohet. E njëjta gjë vlen edhe për aktivet në proces.

Përqindjet e amortizimit të aplikuara në kategoritë e ndryshme të aktiveve afatgjata materiale për vitin 2022 dhe 2021 janë si vijon:

Kategoria e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	Sipas Legjislacionit Tatimor Shqiptar	Sipas Politikave Kontabël të Shoqërisë
Ndërtesa	5%	5%
Instalimet (kryesisht telefonike)	25%	20%
Veturat e transportit (kryesisht për qëllime të brendshme)	20%	25%
Makineri dhe pajisje	20%	6.25%
Pajisjet e zyrës – Mobiljet etj	20%	12%
Pajisjet e zyrës – kompjuterat	25%	20%
Përmirësime të infrastrukturës rrugore	5%	5%

Një element i aktiveve afatgjata materiale dhe çdo pjesë e rëndësishme e njohur fillimisht çregjistrohen me rastin e asgjësimit ose kur nuk priten përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i tij. Çdo fitim ose humbje që del nga çregjistrimi i aktivitetit përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDESISHME KONTABËL (VAZHDIM)

b) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivit vlerësohet. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve është vlera më e madhe e vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes.

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme të vlerësuara do të zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksës që reflekton vlerën aktuale të parasë në tregun aktual dhe risqet specifike të aktivit. Për qëllime të testit të zhvlerësimit, aktivet nuk mund të testohen individualisht por vlerësohen bashkarisht në grupin më të vogël të aktivitetit që gjenerojnë flukse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm që janë të pavarura nga flukset monetare të aktive ose grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese të mjeteve monetare" ose "NGJMN"). Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me një njësi gjeneruese të mjeteve monetare janë alokuar për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve në njësi (grupi i njesive) mbi baza proporcionale. Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi për çdo tregues që humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi kthehen nëse ka patur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën që vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, pa zhvlerësimin ose amortizimin, nëse nuk do të njihet asnjë humbje nga zhvlerësimi.

c) Inventari

Inventari matet me shumën më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përcaktohet duke përdorur parimin e mesatares së ponderuar, dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit ose shndërrimit dhe kosto të tjera të nevojshme për sjelljen e tyre në vendndodhjen dhe kushtet aktuale.

Pjesë këmbimi të konsumueshme

Të konsumueshmet janë materiale ndihmëse të cilat konsumohen në prodhimin e produkteve të përfunduara ose gjysëm të përfunduara.

Pjesët këmbimi janë pjesë të këmbyeshme të aktiveve afatgjata materiale, të cilat konsiderohen të jenë thelbësore për të mbështetur mirëmbajtjen rutinë, riparimin dhe rregullimin e aktiveve materiale ose për t'u përdorur në raste emergjente për riparime. Shoqëria ka llojet e mëposhtme të tipeve të pjesëve të këmbimit:

- Pjesë specifike të veçanta të pajisje të blera së bashku me impiantin ose pas tij, por që lidhen me të njëjtin impiant ose linjë të veçantë prodhimi dhe rrallë do të kërkohen, janë kritike për funksionimin e impiantit dhe duhet të jenë të disponueshme në gjendje gadishmërie në çdo kohë. Këto pjesë kapitalizohen si pjesë e aktiveve afatgjata materiale dhe zhvlerësohen nga data e blerjes për një periudhë që është më e shkurtër se jeta e dobishme e përbërësit apo jeta e dobishme e impiantit në të cilin do të përdoret. Këto nuk janë pjesë të inventarit, me kusht që të plotësohen kriteret e kapitalizimit sipas aktiveve afatgjata materiale.
- Pjesë këmbimi të cilat janë pjesë të këmbyeshme të aktiveve afatgjata dhe pjesë të çiftuara specifike të linjes/linjave të prodhimit me kohë të gjatë përdorimi dhe do të zëvendësohen dhe rinovohen shpesh. Ato kapitalizohen si pjesë e aktiveve afatgjata materiale ku plotësohen kriteret e kapitalizimit. Amortizimi fillon nga dita e instalimit të këtyre artikujve në fabrike dhe periudha e amortizimit është me e shkurtër se jeta e dobishme e pjesës së këmbimit dhe jeta e dobishme e mbetur e aktivitetit afatgjatë material përkatës në të cilin është instaluar. Këto nuk janë pjesë të inventarit.
- Pjesë këmbimi të përgjithshme dhe sende të tjera të konsumit të cilat nuk janë të një natyre kritike dhe kanë natyrë të përgjithshme (jo specifike për një impiant dhe mund të përdoren në impiante të ndryshme ose linja prodhimi dhe çdo send tjetër që mund të kërkohet në çdo kohë për lehtësimin e funksionimit të impiantit).

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDESISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c) Inventari (vazhdim)

- Ato zakonisht klasifikohen si “materiale të konsumit dhe pjesë këmbimi” nën inventar, përveç nëse tejkalojnë pragun e kapitalizimit dhe kanë një jetë të dobishme më shumë se një vit, ku regjistrohen si aktive afatgjata materiale. Artikujt e regjistruar si inventar janë subjekt i vlerësimit për testin e zhvlerësimit dhe paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse pas instalimit apo përdorimit të tyre. Kur artikujt të tillë plotësojnë kriteret e kapitalizimit, metoda e tyre e amortizimit është e ngjashme me artikujt e riparueshëm, të përmendur më lart.

d) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë të paraqitura me kosto të pakësuar për humbjet për zhvlerësime, nëse ka. Humbje nga borxhi i keq njihen bazuar në vlerësimin e kujdesshëm të Shoqërisë për humbjet e pritshme në lidhje me këto llogari të arkëtueshme. Ky vlerësim bazohet në gjendjen financiare të klientëve dhe historiku i borxhit të keq. Borxhi i keq i rikuperuar njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ato ndodhin: Lutem referoju notes 5a) për kalkulimet e HPK. Llogaritë e arkëtueshme njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

e) Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë dhe janë objekt të një risku të parëndësishëm për rënien në vlerë.

f) Huamarrjet, Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Huamarrjet dhe të pagueshmet maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Aktivitetet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose nëse Shoqëria transferon aktivitetin financiar dhe transferimi kualifikohet si mosnjohje. Shoqëria heq detyrimet financiare (ose një pjesë të detyrimeve financiare) nga bilanci i gjendjes kur, ajo është shlyer – p.sh. nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

g) Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojë flukse dalëse monetare për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të pasqyrës me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasqyrës dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

h) Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

i) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në LEK me kursin e këmbimit që në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të paraqitura në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale në datën e raportimit me kursin e asaj date. Diferencat e kurseve të këmbimit të krijuara nga ripërkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

COLACEM ALBANIA SHPK
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31
DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet jomonetare të paraqitura në monedhë të huaj përkthehen në LEK me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Kurset e këmbimit për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EUR/LEK	114.23	120.76
USD/LEK	107.05	106.54

j) Të ardhurat

Të ardhurat nga shitja e mallrave lidhet me shitjet e mallrave me një cmim të caktuar. Ekzekutimi i detyrimit është të dorëzosh një seri mallrash të caktuara dhe cmimi i transaksionit është shuma e të ardhurave që Shoqëria pret të marrë, ose një cmim i caktuar ose cmim i kontratës. Ekzekutimi i detyrimit plotësohet në një moment të caktuar, kështu të ardhurat njihen për çdo njësi të dorëzuar me cmimin e transaksionit.

Shpërndarja ndodh kur mallrat janë dërguar me anije në destinacionin specifik, risqet e vjetërsimit të inventarit dhe humbjes janë transferuar te klienti dhe ose klienti ka pranuar mallra në përputhje me kontratën, provigjionet e pranimi mbaruan, ose Shoqëria ka evidenca objektive që të gjitha kriteret për pranim janë plotësuar. Një kërkesë e arkëtueshme njihet kur mallrat janë dorëzuar sepse në këtë moment të ardhurat nga shitja janë të pakushtëzuara sepse pagesa pritët me kalimin e kohës.

Të ardhurat nga shitja e mallrave do të njihen kur Shoqëria plotëson një detyrimim ekzekutimi duke transferuar një mall të premtuar te klienti. Një mall është transferuar nëse një klient merr kontrollin e aktivitetit.

k) Shpenzime të kryera dhe të kapitalizuara për aktive të ndertuara vete (reduktim shpenzimi)

Shpenzimet njihen kur ato ndodhin. Kostot operative njihen mbi bazën e kostos historike. Keto shpenzime janë kapitalizuar, janë kryer për aktive të ndertuara nga vete shoqëria, ndaj janë paraqitur tek të ardhurat, si reduktim shpenzimi.

l) Shpenzimet

Shpenzimet njihen kur ndodhin. Kostot operative njihen mbi bazën e kostos historike.

m) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi i fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet neto nga kursi i këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit në huamarrje, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare. Fitimet apo humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në vlerë neto.

n) Shpenzimet e personelit

Kontributet për sigurimet shoqërore

Gjatë aktivitetit të saj, Shoqëria kryen pagesa në emër të punonjësve të vet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi. Kostot përkatëse të kryera në emër të Shoqërisë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse sipas ndodhjes së tyre.

Lejet vjetore

Shoqëria njih si shpenzime të personelit ato kosto të lidhura me personelin ekzistues.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABEL (VAZHDIM)

o) Shpenzimi i tatim fitimit

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur në kapitalin neto apo në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi mbi fitimin i periudhës

Tatimi i periudhës përfshin tatimin e pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin dhe çdo rregullim të tatimit për t'u paguar apo arkëtuar në lidhje me vitet e kaluara. Shuma e tatimit të periudhës e pagueshme apo e arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit të pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar i cili reflekton pasigurinë e lidhura me tatimin mbi të ardhurat, nëse ka. Ajo llogaritet duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit. Aktiviteti dhe detyrimi tatimor i periudhës kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kushte të caktuara.

(ii) Tatimi mbi fitimin i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Një aktive për tatime të shtyra njihet për humbjet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është i mundur realizimi i të ardhurave të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Përfitimet e ardhshme tatimore përcaktohen duke u bazuar në rimarrjen e diferencave të përkohshme të zbritshme.

Nëse shumat e diferencave të përkohshme të zbritshme nuk është e mjaftueshme për të njohur një aktiv tatimor të shtyrë, përfitimet tatimore të ardhshme të rregulluara për rimarrjen e diferencave ekzistuese të përkohshme, do konsiderohen bazuar në planin e biznesit.

Aktiviteti tatimor të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri sa të mos jetë më e mundshme të realizohet përfitimi tatimor të lidhura me to; zvogëlimet të tilla rimerren në momentin që rritet probabiliteti i fitimeve të ardhshme tatimore. Aktiviteti për tatime të shtyra të panjohura rivlerësohet në çdo datë raportimi dhe njihet deri në masën që është e mundur që të ketë fitime të ardhshme tatimore kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të rimerren, duke përdorur normat tatimore që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit. Matja e tatimit të shtyrë reflekton efektin tatimor që do të lindin nga mënyra se si Shoqëria pret që në fund të periudhës raportuese, të realizojë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Aktiviteti dhe detyrimet për tatime të shtyra kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kushte të caktuara.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. INSTRUMENTAT FINANCIARE, VLERAT E DREJTA DHE MANAXHIMI I RREZIKUT

Në rrjedhën e zakonshme të operacioneve të saj, Shoqëria është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh financiare siç janë rreziku i normës së interesit, rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i valutës. Drejtimi i përgjithshëm i rrezikut është i përqëndruar në identifikimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në rezultatet financiare dhe pozicionin e Shoqërisë dhe minimizimin e efekteve të mundshme negative që vijnë nga rreziqe të tilla.

a) Instrumentat financiarë

Shoqëria klasifikon aktivet financiare jo derivative në hua dhe të arkëtueshme dhe detyrimet financiare jo derivative në detyrime të tjera financiare.

(i) Instrumentat financiarë jo derivate – Klasifikimi dhe matja

Me njohjen fillestare, një aktiv financiarë klasifikohet si i matur me: kosto të amortizuar; vlerës së drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse VDATGJ - investime në borxh; VDATGJ – investime në kapital; ose vlerës së drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve VDPFH.

Aktivët financiarë nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare të tyre, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit në menaxhimin e aktiveve financiare, rast në të cilin të gjitha aktivët financiarë do të riklasifikohen.

Me njohjen fillestare të një investimi në kapital që nuk mbahet për shitje, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet pasuese në vlerën e drejtë të investimit në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse -PAP (OCI). Keto zgjedhje bëhen investim pas investimi.

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivelin e portofolit sepse kjo pasqyron më së miri mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe informacioni i sigurohet drejtimin. Informacioni i konsideruar përfshin:

- Politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë, këto përfshijnë nëse strategjia e drejtimin fokusohet në fitimin e flukseve monetare kontraktuale, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e cdo detyrimi të lidhur ose daljet e parave të pritshme ose realizimin e flukseve të parasë përmes shitjes së pasurive;
- Si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit tek drejtimi i Shoqërisë;
- Rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aktivët financiarë të mbajtura sipas modelit të biznesit) dhe mënyrën se si menaxhon këto rreziqe
- Shpeshtësia, volumi dhe koha e shitjes së aktiveve financiare në periudhat e mëparshme, arsyet për këto shitje dhe pritjet për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve.

Si rezultat i vlerësimit të modelit të biznesit, Shoqëria klasifikon bilancet e llogarive të arkëtueshme, subjekt i marrëveshjeve të faktoringut të kundërt, si aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse.

(ii) Instrumentat financiarë jo derivate – Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Instrumentat financiarë dhe aktivët kontraktuale

Shoqëria njihet provigjonet për humbje për humbjen e pritshme të kredisë (HPK) në:

- aktivët financiarë të matura me koston e amortizuar
- aktivët financiarë të matura me VDATGJ;
- aktivët kontraktuale

Provigjonet e humbjeve për të arkëtueshmet tregtare dhe aktivët kontraktuale gjithmonë maten në një shumë të barabartë me HPK e përjetshme.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. INSTRUMENTAT FINANCIARE, VLERAT E DREJTA DHE MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

a) Instrumentat financiar (vazhdim)

(ii) Instrumentat financiare jo derivate – Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Kur përcaktohet nëse rreziku i kredisë së një aktivi financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe kur vlerëson HPK, Shoqëria konsideron informacion të arsyeshëm dhe të mbështetur që është i rëndësishëm dhe i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacionin dhe analizën sasiore dhe cilësore të bazuar në eksperiencën historike të Shoqërisë dhe vlerësimin e informar të kredisë duke përfshirë informacionin e ardhshëm.

Shoqëria konsideron që një aktiv financiar është i papaguar kur:

- klienti ka dështuar në një marrëveshje faktORIZIMI ose marrëveshje për financimin e klientit;
- klienti është subjekt ose i ekspozuar potencialisht ndaj një ristrukturim borxhi;
- burimet e jashtme të financimit të klientit pezullohen për arsye të klientit;
- prova të reja të konfirmuara tregojnë një rrezik të lartë mospagimi;
- kontrata ka tejkaluar ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë (sic është kufiri i kredisë);
- kontrata ka një rregullim të zbutjes së rrezikut (sic është garancia);
- kontrata ka një komponent të rëndësishëm financimi;
- vendet me rrezik të lartë të publikuara nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut të Grupit;
- të tjera (rreziqet specifike të vendit).

Një aktiv financiar që nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit/humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar zhvlerësim. Një aktiv financiar ka pësuar zhvlerësim nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në zhvlerësim të tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e ardhshme të parasë nga aktivi, të cilat mund të maten me besueshmëri. Humbja nga zhvlerësimi i aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël neto dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Humbjet njihen në pasqyrën e fitim & humbjes dhe reflektohen në një llogari provigjoni që është kunderparti i llogarive të arkëtueshme.

Interesi nga aktivet e zhvlerësuara vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet fitim ose humbjes.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar shlyhet kur Shoqëria nuk ka pritje të arsyeshme për rikuperimin e një aktivi financiar në tërësinë e saj ose një pjesë të tij. Shoqëria nuk pret ndonjë rikuperim të konsiderueshëm nga shumat e shlyer, sidoqoftë, aktivet financiare që janë fshirë mund të jenë akoma subjekt i aktiviteteve të zbatimit në mënyrë që të jenë në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave të duhura.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to mbahen në KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. INSTRUMENTAT FINANCIARE, VLERAT E DREJTA DHE MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

a) Instrumentat financiarë (vazhdim)

(ii) *Instrumentat financiarë jo derivate – Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)*

Llogaritë e arkëtueshme. Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e alokimit të të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël neto. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat e ardhshme të parasë ose arkëtimet (duke përjashtuar humbjet e pritshme të kredisë) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël bruto të instrumentit financiar.

Llogari të pagueshme. Llogaritë e pagueshme njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performancës sipas kontratës dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

b) Vlerat e drejta

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe informacione shpjeguese të miratuara nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to, llogarive të arkëtueshme tregtare dhe pagesave të tregtisë dhe të tjera janë përafërsisht të barabarta me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të tyre afatshkurtër.

c) Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare :

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të kompanisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut, si dhe manaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Dhënia e informacioneve shpjeguese të mëtejshme sasiore përfshihet në këto pasqyra financiare.

Shoqëria ka një depozitë me afat të konsideruar si aktiv me interes ndërkohë që ajo nuk ka detyrime afatshkurtra dhe afatgjata huaje me interes.

i. Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar dështon të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe rrjedh kryesisht nga të arkëtueshmet e Shoqërisë nga klientët. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Megjithatë, Drejtimi gjithashtu konsideron faktorët që mund të ndikojnë në rrezikun e kredisë të bazës së saj të klientëve, duke përfshirë rrezikun e parazgjedhur që lidhet me industrinë në të cilën klientët veprojnë. Provigjoni për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta përcaktohen në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në mbledhjen e gjendjes së llogarive të arkëtueshme.

Maturimi i llogarive të arkëtueshme tregtare në datën e raportimit dhe zhvlerësimi i tyre paraqitet si më poshtë:

COLACEM ALBANIA SHPK

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. INSTRUMENTAT FINANCIARE, VLERAT E DREJTA DHE MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

c) Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

i. Rreziku i kredisë (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Më pak se një vit	181,285,867	146,710,447
Më shumë se një vit	-	-
Totali bruto	181,285,867	146,710,447
Provizioni për zhvlerësim	-	-
Të arkëtueshme neto	181,285,867	146,710,447

Shoqëria kufizon ekspozimin ndaj rrezikut të kreditit nga të arkëtueshmet tregtare duke monitoruar periudhën maksimale të pagesës prej 30 dhe 60 ditë për klientët e saj. Asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur kundrejt këtyre klientëve gjatë vitit 2022. Shoqëria nuk konsiderohet e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë që do të ndikonte në pozicionin dhe performancën e saj financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022.

Tabela më poshtë paraqet instrumentat financiare për vitin 2021 sipas shkallëve të IFRS9:

Shkallët sipas Humbjes së Pritshme të Aktiveve
Financiare më 31 dhjetor 2022

	Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3	Totali
Të arkëtueshme tregtare	178,654,290	2,631,577	-	181,285,867
Vlera bruto	178,654,290	2,631,577	-	181,285,867
Humbja e pritshme	-	-	-	-
Vlera kontabël neto	178,654,290	2,631,577	-	181,285,867

Shkallët sipas Humbjes së Pritshme të Aktiveve
Financiare më 31 dhjetor 2021

	Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3	Totali
Të arkëtueshme tregtare	138,403,834	6,912,881	1,393,732	146,710,447
Vlera bruto	138,403,834	6,912,881	1,393,732	146,710,447
Humbja e pritshme	-	-	-	-
Vlera kontabël neto	138,403,834	6,912,881	1,393,732	146,710,447

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

5 INSTRUMENTAT FINANCIARE, VLERAT E DREJTA DHE MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)**c) Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****ii. Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare që shlyhen duke dhënë hua ose ndonjë aktiv financiar tjetër. Qasja e shoqërisë për manaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe të stresuara, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

Rreziku i likuiditetit manaxhohet përmes monitorimit të fluksit të parave nga operacionet.

Tabela e mëposhtme tregon maturimit kontraktual të aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

31 dhjetor 2022	Vlera neto	0-3 muaj	3-12 muaj
<i>Aktive financiare</i>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	104,475,877	104,475,877	-
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	603,006,656	498,611,422	104,395,234
Totali	707,482,533	603,087,299	104,395,234
<i>Detyrime financiare</i>			
Llogari të pagueshme	(395,330,204)	(395,330,204)	-
Detyrime të tjera	(10,514,811)	(10,514,811)	-
Totali	(405,845,015)	(405,845,015)	-
Hendeku i likuiditetit	301,637,518	197,242,284	104,395,234
Kumulative	301,637,518	104,395,234	-
31 dhjetor 2021	Vlera neto	0-3 muaj	3-12 muaj
<i>Aktive financiare</i>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	106,499,843	106,499,843	-
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	415,806,644	238,716,495	177,090,149
Totali	522,306,487	345,216,338	177,090,149
<i>Detyrime financiare</i>			
Llogari të pagueshme	(243,340,454)	(243,340,454)	-
Detyrime të tjera	(7,351,979)	(7,351,979)	-
Totali	(250,692,433)	(250,692,433)	-
Hendeku i likuiditetit	271,614,054	94,523,905	177,090,149
Kumulative	271,614,054	177,090,149	-

iii. Rreziku i tregut

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare të zvogëlohet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Ekspozimet e këmbimeve valutore të shoqërisë krijojnë fitime dhe humbje në valutë të huaj që njihen në fitim ose humbje. Këto ekspozime përfshijnë mjetet monetare dhe pasivet monetare të Shoqërisë të cilat nuk janë të shprehura në lekë.

COLACEM ALBANIA SHPK
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31
DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. INSTRUMENTAT FINANCIARE, VLERAT E DREJTA DHE MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIMI)

c) Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

iii. Rreziku i tregut (vazhdim)

Normat e aplikueshme të këmbimit (LEK në njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore në datën e raportimit ishin më poshtë. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si vijon:

31 dhjetor 2022	Vlera neto	EUR	LEK
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	104,475,877	79,953,313	24,522,564
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	603,006,656	181,285,867	421,720,789
Llogari të pagueshme	(395,330,204)	(301,628,748)	(93,701,456)
Detyrime të tjera	(10,514,811)	-	(10,514,811)
Totali	301,637,518	(40,389,568)	342,027,086

31 dhjetor 2021	Vlera neto	EUR	LEK
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	106,499,843	77,782,625	28,717,218
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	415,806,644	146,710,447	269,096,197
Llogari të pagueshme	(243,340,454)	(225,524,595)	(17,815,859)
Detyrime të tjera	(7,351,979)	-	(7,351,979)
Totali	271,614,054	(1,031,523)	272,645,577

Rreziku i monedhës manaxhohet duke monitoruar shkallën e përputhjes midis arkëtimit dhe shlyerjes së aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë transaksion përpara ose transaksione të produktit derivativ nga 31 dhjetori 2022 dhe 2021.

Analiza e ndjeshmërisë për monedhat e huaja

Analiza e mëposhtme e ndjeshmërisë është përcaktuar duke u bazuar në ekspozimin ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit dhe ndryshimit të ndodhur në fillim të vitit financiar dhe të mbajtur konstant gjatë gjithë periudhës raportuese. Në vijim është një parashikim i efekteve nga ndryshimi i kursit të këmbimit në humbjen neto, duke mbajtur të gjithë variablat e tjerë konstante:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EUR zhvlerësohet me 10%	4,038,957	103,152
EUR vlerësohet me 10%	(4,038,957)	(103,152)

COLACEM ALBANIA SHPK
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

6. AKTIVET MATERIALE AFATGJATA

Aktivët afatgjatë më 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

<i>Kosto</i>	Përmiresimet			Veturat dhe mjetet e transportit		Aktivë në proces		Total
	Toka	Ndërtesa	infrastrukturës rrugore	Makinëri dhe pajisje	brendshëm	Pajisje zyre	Mobilje	
Më 1 janar 2022	249,310,171	1,321,500,627	75,544,870	2,511,556,519	182,281,698	33,399,247	21,291,036	4,441,944,122
Shtesat	-	-	-	1,765,000	-	199,127	362,185	42,021,996
Pakësimet	-	-	-	-	(10,398,748)	-	-	(10,398,748)
Tepërca më 31 dhjetor 2022	249,310,171	1,321,500,627	75,544,870	2,513,321,519	171,882,950	33,598,374	21,653,221	4,473,567,370
Zhvlërësimi i akumuluar								
Më 1 janar 2022	-	(604,824,528)	(43,464,174)	(1,436,621,962)	(157,848,892)	(28,970,023)	(19,025,781)	- (2,290,755,360)
Zhvlërësimi i vitit	-	(66,075,031)	(3,777,244)	(154,049,559)	(10,085,465)	(1,686,521)	(391,684)	- (236,065,504)
Pakësimet	-	-	-	-	8,468,569	-	-	8,468,569
Tepërca më 31 dhjetor 2022	-	(670,899,559)	(47,241,417)	(1,590,671,521)	(159,465,789)	(30,656,544)	(19,417,465)	- (2,518,352,295)
Vlera neto								
Më 1 janar 2022	249,310,171	716,676,098	32,080,696	1,074,934,558	24,432,805	4,429,225	2,265,255	2,151,188,762
Më 31 dhjetor 2022	249,310,171	650,601,067	28,303,455	922,649,999	12,417,161	2,941,829	2,235,756	1,955,215,075

Në zërin e aktiveve në proces është përfshirë vlera 20,247,760 lekë, e cila lidhet me shpenzime të kryera dhe të kapitalizuara për aktive të ndërtuara vetë (2021: 0). Asnjë prej zërave të aktiveve afatgjatë materiale nuk është lënë kolateral më 31 dhjetor 2022 (2021: asnjë).

COLACEM ALBANIA SHPK

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

6. AKTIVET MATERIALE AFATGJATA (VAZHDIM)

Aktivet afatgjata më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Përmirësimet e			Veturat dhe		Aktive në	
	Toka	Ndërtesa	infrastrukturë s rrugore	Makineri dhe pajisje	transportit të brendshëm	Pajisje zyre	proçes
Më 1 janar 2021	249,310,171	1,321,500,627	75,544,870	2,509,748,971	174,929,852	32,752,118	-
Shtesat	-	-	-	1,807,548	13,607,783	647,129	-
Pakësimet	-	-	-	-	(6,255,937)	-	-
Teprica me 31 dhjetor 2021	249,310,171	1,321,500,627	75,544,870	2,511,556,519	182,281,698	33,399,247	47,059,954
4,441,944,122							
Zhvlerësimi i							
akumuluar							
Më 1 janar 2021	-	(538,749,497)	(39,686,930)	(1,282,700,761)	(153,934,284)	(27,085,038)	-
Zhvlerësimi i vitit	-	(66,075,031)	(3,777,244)	(153,921,201)	(10,170,545)	(1,884,985)	-
Pakësimet	-	-	-	-	6,255,937	-	-
Teprica më 31 dhjetor 2021	-	(604,824,528)	(43,464,174)	(1,436,621,962)	(157,848,892)	(28,970,023)	-
(2,290,755,360)							
Vlera neto							
Më 1 janar 2021	249,310,171	782,751,130	35,857,940	1,227,048,210	20,995,568	5,667,080	-
Më 31 dhjetor 2021	249,310,171	716,676,098	32,080,696	1,074,934,558	24,432,805	4,429,225	47,059,954
2,151,188,762							

Asnjë prej zërave të aktiveve afatgjata materiale nuk është lënë kolateral më 31 dhjetor 2021 (2020: asnjë).

COLACEM ALBANIA SHPK**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)***7. AKTIVE JO MATERIALE AFATGJATA**

Aktivet afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Teprica më 1 janar	5,812,209	2,428,881
Shtesa	167	3,383,328
Pakësime	-	-
Teprica më 31 dhjetor	5,812,376	5,812,209
Amortizimi i akumuluar		
Teprica më 1 janar	(2,430,027)	(2,279,744)
Amortizimi për vitin	(713,219)	(150,283)
Pakesime për vitin	-	-
Teprica më 31 dhjetor	(3,143,246)	(2,430,027)
Vlera neto		
Më 1 janar	3,382,181	149,137
Më 31 dhjetor	2,669,130	3,382,181

Aktivet jo-materiale afatgjata përfaqësojnë software dhe aktivet e lidhura me to.

8. INVENTARI

Mallrat e përfunduar përfaqësojnë vlerën e çimentos të gatshme për shitje në treg. Vlera e mallrave është vlerësuar me koston më të ulët dhe çmimin mesatar të shitjes të muajit dhjetor të të njëjtit vit. Kosto e mallrave të përfunduara përfshin: amortizimin, energjinë elektrike, koston e punës, koston e mirëmbajtjes dhe të lëndës së parë (klinker, shtues dhe gëlqere).

Teprica e lëndës së parë përfshin klinkerin, karburantin, materialet e përdorura për mirëmbajtje të aktiveve materiale dhe mjete të tjera të punës. Inventari më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Mallra për rishitje	254,026,923	138,943,652
Lëndë e parë	228,866,529	188,353,779
Totali	482,893,452	327,297,431

9. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Klientë vendas	175,051,551	128,599,645
Klientë të huaj	6,234,316	18,110,802
Totali	181,285,867	146,710,447

COLACEM ALBANIA SHPK**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)***9. LLOGARI TË ARKËTUESHME (VAZHDIM)**

Llogaritë e arkëtueshme sipas maturimit të tyre paraqiten më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
As ditë vonesa dhe as zhvlerësim	137,589,864	103,864,413
Totali	137,589,864	103,864,413
Në vonesë dhe jo të zhvlerësuara		
1 – 3 muaj	43,696,003	41,452,302
3 – 6 muaj	-	1,393,732
6 – 12 muaj	-	-
Totali	43,696,003	42,846,034
Totali llogarive të arkëtueshme	181,285,867	146,710,447

10. AKTIVE TË TJERA

Aktive të tjera paraqiten më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
TVSH e rimbursueshme	317,325,555	93,399,780
TVSH e zbritshme	98,801,806	171,328,184
Parapagimi i detyrimeve doganore e te tjera	5,593,428	4,368,233
Totali	421,720,789	269,096,197

TVSH-ja e rimbursueshme, e cila është arkëtuar nga shoqëria në muajin prill 2023, është në vlerën 166,142,908 leke.

11. PARAPAGIME DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Parapagime dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Shpenzime të shtyra	14,715,777	15,392,917
Garanci	14,022,314	14,022,314
Shpenzime të parapaguara të tjera	6,597,569	6,851,064
Total	35,335,660	36,266,295

Shpenzimet e shtyra lidhen me shpenzimet që Shoqëria ka bërë për të përmirësuar sipërfaqen e tokës prej 190 HA (përveç rehabilitimit të tokës që përdoret si karriere) e cila është amortizuar gjatë kohëzgjatjes së licensës së minierës dhe shpenzimeve të shtyra për faturat e ardhura gjatë vitit 2022.

Garancitë përfshijnë garancitë për investimet dhe planin e rehabilitimit të tokës sikurse kërkohet nga leja minerare e shfrytëzimit e datës 28 gusht 2018. Sipas kushteve të përcaktuara në lejen minerare, Shoqëria është e detyruar të garantojë rehabilitimin e tokës pas shfrytëzimit.

Shpenzime të tjera të parapaguara përfshijnë sigurimin e fabrikës dhe të veturave.

COLACEM ALBANIA SHPK
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31
DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

12. MJETET MONETARE DHE EKUVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Banka	103,884,683	105,666,998
EUR	79,677,173	77,440,211
LEK	24,207,510	28,226,787
Paraja në arka	591,194	832,845
EUR	276,140	342,414
LEK	315,054	490,431
Totali	104,475,877	106,499,843

13. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i nënshkruar përbëhet nga 100 aksione kuota me vlerë nominale 5,737,034 LEK për aksion.

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Kapitali i nënshkruar	5,737,034,235	5,737,034,235
Totali	5,737,034,235	5,737,034,235

14. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Të pagueshme ndaj palëve të treta	137,740,512	91,064,232
Të pagueshme ndaj shoqërive të grupit	118,531,828	11,128,428
Shpenzime të llogaritura për shërbime nga palët e treta	82,548,279	33,150,076
Të pagueshme ndaj shoqërisë mëmë	54,398,447	108,818,720
Shpenzime të llogaritura për shërbime nga palët e lidhura	2,111,138	(821,002)
Totali	395,330,204	243,340,454

Të pagueshme në fund të vitit i referohen faturave të blerjeve të klinkerit të bëra në muajin dhjetor 2022, të cilat në datën e pasqyrave financiare nuk ishin të likuiduara. Sipas kushteve të rëna dakord mes palëve, afati i pagesës është 30 ditë nga data e faturës.

15. DETYRIME TË TJERA

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Të pagueshme ndaj punonjësve	5,769,379	4,528,022
Të pagueshme për sig. shoqërore dhe shëndets.	2,202,586	1,820,477
Tatim mbi fitimin	1,260,336	-
Të pagueshme për tatim të ardhurave nga punësimi	1,159,289	955,544
Detyrime të tjera	88,494	47,936
Parapagime nga klientët	34,727	-
Totali	10,514,811	7,351,979

COLACEM ALBANIA SHPK
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31
DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

16. PROVIGJONE AFATSHKURTRA

Provigjonet për detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten respektivisht në shumat 31,324,296 LEK dhe 31,324,296 LEK.

Lëvizjet e fondit për provigjonet afatshkurtra:

	2022	2021
Balanca celëse më 1 janar	31,324,296	31,324,296
Lëvizje të provigjoneve	-	-
Teprica mbyllëse më 31 dhjetor	31,324,296	31,324,296

Për vitet 2021 dhe 2022, nuk ka shtesa të provigjoneve.

17. TË ARDHURAT

Shoqëria prodhon dhe kontraktin me klientët për shitjen e çimentos që zakonisht përfshijnë një detyrim të vetëm të performancës. Drejtimi ka përcaktuar që të ardhurat nga shitja e mallrave të njihen në momentin që kontrolli i aktivitetit transferohet te konsumatori, i cili është në momentin e dorëzimit të mallit. Dorëzimi ndodh kur produktet janë dërguar ose transportuar në një vend specifik dhe rreziqet e humbjes u janë transferuar klientëve. Transferimi mund të bëhet ose në formën e pranimet nga klienti të produktit sipas kontratës së shitjes. Fatura gjenerohen dhe të ardhurat njihen në atë moment kohor. Të ardhurat maten bazuar në konsideratën e specifikuar në një kontratë me një klient.

Të ardhurat nga shitja e mallrave detajohet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shitja e mallrave (në Shqipëri)	2,553,819,997	1,789,305,609
Shitja e mallrave (eksport)	1,092,197,858	700,462,154
Totali	3,646,017,855	2,489,767,763

Mallrat përgjithësisht shiten në bazë të kontratimeve që kanë një cmim fiks për njësi. Shitjet faturohen me kryerjen e detyrimit. Termat e pagesave variojnë nga klientët dhe produktet e shitura. Koha midis faturimit dhe pagesës nuk është e konsiderueshme.

18. TË ARDHURA TË TJERA NGA VEPRIMTARITË OPERATIVE

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë operative përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga shitjet e aktiveve afatgjata	3,306,921	570,980
Shërbime të tjera	3,779,133	281,664
Totali	7,086,054	852,644

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

19. SHPENZIME TE KRYERA DHE TE KAPITALIZUARA PER AKTIVE TE NDERTUARA VETE (REDUKTIM SHPENZIMI)

Shpenzimet e kryera dhe te kapitalizuara për aktive të ndërtuara vetë (reduktim shpenzimi) detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime te kryera dhe te kapitalizuara per aktive te ndertuara vete (reduktim shpenzimi)	20,247,760	-
Totali	20,247,760	-

Shpenzimet e kryera dhe te kapitalizuara për aktive të ndërtuara vetë (reduktim shpenzimi) gjatë vitit 2022 janë në vlerën 20,247,760 leke (2021:0). Këto shpenzime lidhen kryesisht me punime në proces për ndërtimin e silos së klinkerit.

20. SHPENZIME PËR MATERIALE

Shpenzime për materiale përbëhen nga blerja e lëndës së parë klinker për prodhimin e çimentos për rishitje dhe kostot që kanë të bëjnë me: transportin, detyrimet doganore dhe karburantin. Gjatë vitit 2022 shoqëria ka patur një rritje të ndjeshme të kostove për blerjen e lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin e çimentos, të cilat kanë ardhur si rezultat i rritjes së çmimeve në nivel global. Shpenzimet për materiale detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2022	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Kosto e lëndës së parë dhe materiale ndihmëse	2,491,146,023	1,536,249,387
Shpenzime të tjera materiale	283,147,385	203,275,040
Ndryshimi në inventar	(155,596,020)	(16,827,677)
Totali	2,618,697,388	1,722,696,750

COLACEM ALBANIA SHPK**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)***21. SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË OPERATIVE**

Shpenzime të tjera nga veprimtaritë operative detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2022	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Energji elektrike dhe ujë	561,842,432	177,049,475
Transport	56,617,655	64,979,294
Shërbime konsulence, ligjore dhe financiare	46,096,947	42,273,860
Shpenzime për minieren e gurit	19,036,128	17,785,579
Taksa	13,188,079	12,954,486
Shërbime sigurie	6,651,374	6,202,815
Sigurimi	5,741,623	5,077,887
Shërbimet e mirëmbajtjes	4,051,468	8,813,483
Shpenzime administrative	2,397,465	1,797,018
Karburant	2,304,836	1,513,712
Shërbime auditimi	2,297,365	4,356,433
Shpenzime telefoni	1,474,111	1,302,743
Reklama	1,462,447	1,024,968
Komisione bankare	1,445,586	1,202,624
Shpenzime përfaqësimi	1,205,415	9,551,926
Shpenzime udhëtimi	991,653	766,208
Shërbime për mirëmbajtjen e makinave	578,098	861,140
Qira	263,017	407,276
Gjoha	35,619	15,416
Shpenzime të rehabilitimit	-	2,198,988
Shpenzime të tjera	2,339,384	2,145,772
Totali	730,020,701	362,281,103

Shpenzimet e qirasë lidhen me qira makine/mjetesh.

Rritja e shpenzimeve të zërit "Energji elektrike dhe ujë" lidhet me rritjen e çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2022. Çmimi mesatar i energjisë elektrike është rritur me rreth 213% (në 2021 ishte 99.06 Eur/MVH, ndërsa në 2022 ishte 310 Eur/MWH).

22. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personeli detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime page	90,594,287	85,351,311
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	12,700,578	12,055,005
Totali	103,294,865	97,406,316

COLACEM ALBANIA SHPK**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)***23. FITIMI FINANCIAR**

Fitimi/(humbja) financiare detajohet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitimi nga kursi i këmbimit	43,722,985	12,558,936
Humbje nga kursi i këmbimit	(33,641,167)	(10,345,286)
Shpenzime interesi	(433,024)	(2,593)
Shpenzime të tjera financiare	(2,493,709)	(2,037)
Totali	7,155,085	2,209,020

24. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	(10,737,552)	74,164,225
Shpenzimet e pazbritshme	111,536,141	101,286,329
Përdorimi i humbjeve të mbartura tatimore të panjohura më parë	(92,396,350)	(175,450,554)
Fitimi/(Humbja) e tatueshme e vitit	8,402,239	-
Tatimi mbi fitimin 15% (2021: 15%)	1,260,336	-

Tatimi mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 sipas legjislacionit shqiptar është 15% (2021: 15%). Humbjet mund të mbarten për një periudhë 3 vjeçare dhe të përdoren kundër fitimeve të ardhshme të tatueshme. Shpenzimet e pazbritshme përfaqësojnë kryesisht shpenzime jo të mbështetura me dokumentacion të rregullt tatimor.

	Tax rate	2022	Tax rate	2021
(Humbja)/fitimi para tatimit	-	(10,737,552)	-	74,164,225
Norma e tatimit 15% (2021: 15%)	15%	(1,610,633)	15%	11,124,634
(Humbja)/fitimi i tatueshëm i mbartur	129%	(13,859,453)	-35%	(26,317,583)
Shpenzimet e pazbritshme	-156%	16,730,421	20%	15,192,949
Shpenzimi i tatim fitimit	-12%	1,260,336	0%	0

COLACEM ALBANIA SHPK
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

24. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)
i. Tatimi i shtyrë

Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë bërë vlerësime, por nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra për sa i përket zërave të mëposhtëm:

	2022		2021	
	Vlera bruto	Efekti tatimor	Vlera bruto	Efekti tatimor
Humbjet tatimore nga 2017	-	-	-	-
Humbjet tatimore nga 2018	-	-	(194,116,937)	(29,117,541)
Humbjet tatimore nga 2019	(92,396,350)	(13,859,452)	(92,396,350)	(13,859,453)
Përdorimi i humbjeve tatimore 2020	-	-	-	-
Përdorimi i humbjeve tatimore 2021	-	-	175,450,554	26,317,583
Humbjet tatimore të mbartura që skadojnë deri në fund të vitit	(92,396,350)	(13,859,452)	18,666,383	2,799,957
Shuma totale e humbjeve tatimore të mbartura në fund të vitit	(92,396,350)	(13,859,452)	(92,396,350)	(13,859,453)
			(331,527,880)	(49,729,182)
Totali	(92,396,350)	(13,859,452)	(423,924,230)	(63,588,635)

Sipas legjislacionit shqiptar, diferencat e përkohshme të zbritshme nuk mbyllen. Diferencat e zbritshme të përkohshme vijnë nga zëri i aktiveve afatgjata materiale dhe lidhen me diferencën në kohë të njohjes së zhvlerësimit për qëllime tatimore.

Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021, Shoqëria nuk ka njohur asnjë aktiv tatimor të shtyrë në lidhje me këto zëra, sepse nuk ka siguri se fitimi i vitit financiar në të ardhmen do të jetë mjaftueshëm për të kompensuar humbjet e mbartura fiskale.

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Nje palë e lidhur është një person ose një njësi ekonomike që është i lidhur me njësinë ekonomike raportuese: një person ose një anëtar i afërt i familjes së atij personi i cili ka kontroll, kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm mbi njësinë ekonomike ose është anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike; ndër rrethana të tjera, është një prind, filial, shoqëri e përbashkët ose ndërmarrje e përbashkët e njësisë ekonomike raportuese, ose ka kontroll, kontroll të përbashkët, ose ndikim të rëndësishëm ose manaxhim nga një person që është palë e lidhur. Nje transaksion me palët e lidhura është transferimi i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pavarësisht nëse është vënë një çmim. Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura është si vijon:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Pasqyra e pozicionit financiar		
Të arkëtueshme nga Colacem SpA (shih shënimin 9)s	6,234,316	-
Totali i të arkëtueshmeve nga palët e lidhura	6,234,316	-
Të pagueshme për Colacem SpA (shih shënimin 14)	56,509,585	107,997,718
Të pagueshme për Les Ciment Artificiels Tunisiens S.A. (shih shënimin 14)	118,531,828	11,128,428
Totali i të pagueshmeve për palët e lidhura	175,041,412	119,126,146

COLACEM ALBANIA SHPK**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)***25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)**

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Colacem SpA	54,008,790	415,222,101
Les Ciment Artificiels Tunisiens S.A.	365,177,561	68,566,341
Ragusa Cementi Srl	21,860	-
Tracem	6,031	-
Totali i mallrave të blerë	419,214,242	483,788,442
Colacem SpA	8,823,946	28,440,156
Totali i shërbimeve të marra	8,823,946	28,440,156

Në shërbimet e marra nga palët e lidhura, përkatësisht nga Colacem SpA, përfshihen shërbime menaxhimi në vlerën 19,720,071 lekë (2021: 10,641,773 lekë).

26. DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Here pas here dhe në rrjedhën normale të biznesit, mund të merren pretendime kundër Shoqërisë. Shoqëria ka disa çështje gjyqësore kundër autoriteteve tatimore. Në bazë të vlerësimeve të veta dhe këshillave profesionale të brendshme dhe të jashtme, drejtimi është i mendimit se humbjet materiale të mëposhtme janë të mundshme në lidhje me keto pretendime, dhe në përputhje me këtë, një provigjon prej 31,324,296 lek është përfshirë në pasqyrat financiare (referojuni shënimit 17).

Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. 7904/1 prot., datë 21.10.2015 lëshuar nga Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj, paditësi u njoftua për detyrimin tatimor, i përbërë nga Tatimi mbi fitimin dhe TVSH-ja për periudhën 2013 - 2015 në shumën 40,851,196 LEK. Drejtoria e Apelit Tatimor, e cila me vendimin nr. 38501/4 prot., datë 23.02.2016, vendosi të ndryshojë pjesërisht Njoftim Vlerësimin në fjalë, duke zvogëluar shumën e detyrimit tatimor me 25.077,456 Lek. Paditësi ngriti një padi në Gjykatën Administrative të Tiranës, duke kërkuar anulimin e akteve administrative të lartpërmendura për detyrimet e mbetura tatimore. Me vendim të datës 13.06.2016, Gjykata Administrative e Tiranës rrëzoi kërkesën e paditësit. Paditësi ankimoi kundër këtij vendimi Gjykata Administrative e Apelit, e cila më 01.03.2018 konfirmoi vendimin e Gjykatës Administrative të Tiranës. Aktualisht çështja është në shqyrtim në Gjykatën Supreme, e cila nuk ka caktuar ende një datë për shqyrtimin e çështjes. Drejtimi nuk pret që Gjykata Supreme të ndryshojë vendimin e apelit dhe ka ndryshuar provizionin e njohur për detyrimet e mbetura tatimore në shumën 15,831,872 LEK në vitin 2018 (shih shënimin 16).

Me Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 11485/7 prot., datë 27.10.2016 lëshuar nga Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj, paditësi ishte njoftuar për detyrimet tatimore, të cilat konsistojnë në TVSH në shumën prej 41,775,854 LEK për detyrim principal dhe gjoba si dhe refuzimin e rimbursimit të TVSH-së në vlerën 33,430,155 LEK. Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin nr. 2052/3 prot., datë 27.06.2017 vendosi të anulojë pjesërisht detyrimet e përcaktuara në Njoftim Vlerësimin e mësipërm. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4605 prot. datë 30.11.2017 vendosi të pranojë pjesërisht ankimin e Shoqërisë në vlerën 33,430,155 LEK dhe rrëzojë pjesën e mbetur të ankimimit. Të dyja palët kanë apeluar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Çështja ka mbetur pezull pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Pjesa e mbetur e detyrimeve tatimore në shumën 31,382,428 LEK është provigjonuar plotësisht nga Shoqëria si është sqaruar në shënimin 16.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

27. NGJARJE PAS DATES SË RAPORTIMIT

Nga verifikimet rezulton se nuk ka asnjë përditësim në lidhje me çështjet gjyqësore ekzistuese si dhe nuk ka çështje të reja gjyqësore të hapura gjatë vitit 2022.

Pas kërkeses për rimbursim të TVSH-se, vlera e TVSH-se se rimbursueshme e aprovuar është 216,858,428 leke, nga e cila, vlera 166,142,908 leke është arketuar nga shoqëria në llogarinë bankare të saj më 28.02.2023, ndërsa 50.715.520 leke është përdorur për kompensime të detyrimeve të TVSH-se. Sipas vendimit të Drejtorisë së Apelit të Tatimor me nr. 214/2 datë 11.04.2023, është vendosur që të lihen në fuqi detyrimet e TVSH-se në vlerën 3,124,494 leke dhe të shfuqizohen detyrimet e TVSH-se në vlerën 3,945,853 leke. Nuk ka pasur ngjarje të tjera pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin veprim rregullues apo shënim shpjegues në këto pasqyra financiare. Për ngjarjet e mësipërme të paraqitura nuk ka nevojë për rregullime në pasqyrat financiare.